



**KONTRATE**

(Për transferimin e aksioneve të shoqërisë "A.S.K" OIL Sh.a)

Sot në Tiranë me datë 18.5.2011 (dymijë e njembdhjetë), përpara meje noterit të Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqitën personalisht palët e mëposhtme:

**SHITESI:** Z. Andi Kume, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 11.12.1983, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 029558735, titullar i 67 aksioneve që përfaqësojnë 67% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, madhor e me zotësi të plote për të vepruar.

**Dhe**

**BLERESI:** Z. Xhezmi Kadi, shtetas shqiptar, lindur në Korçë, më 16.08.1959, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 030874149, titullar i 33 aksioneve që përfaqësojnë 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë, madhor e me zotësi të plote për të vepruar.

**MEQENESE**

- Shitësi zotëron 67 aksioneve të shoqërisë të cilat përbejnë 67% të kapitalit të Shoqërisë "A.S.K" OIL Sh.a (Shoqëria), shoqëri aksionare e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, mbajtëse e NUIS - K82109004K.
- Shoqëria ka një kapital të regjistruar në vlerën Lek 2.000.000 (dy milion) i ndare në 100 (njëqind) aksione me vlerë nominale 20.000 (njëzet mijë) lek secili;
- Shitësi dhe Blerësi kanë rënë dakord që Shitësi të shesë Blerësit 67 aksione që përbejnë 67% të kapitalit të Shoqërisë;
- Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi aksionet e specifikuara më sipër;
- Aksionet shiten (transferohen) me vlerën e tyre nominale siç është përcaktuar me poshtë në këtë kontratë.

Meqenëse ekzistojnë kushtet më sipër, palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

**1. Objekti i Kontratës**

Sipas kushteve të parashikuara në këtë Kontratë, Shitësi transferon tek Blerësi dhe ky i fundit bien nga Shitësi 67 (gjashtedhjetë e shtatë) aksione që përbejnë 67% të kapitalit të Shoqërisë;

**2. Çmimi i shitjes**

Aksionet shiten (transferohen), kundrejt vlerës së tyre nominale prej Lek 20.000 (njëzet mijë) lek, për çmimin total prej 1.340.000 (një milion e treqind e dyzete mijë), i cili është paguar plotësisht nga Blerësi jashtë zyrës noteriale.

**3. Transferimi i pronësisë mbi aksionet**

Pronësia mbi aksionet transferohet menjëherë nga Shitësi tek Blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

**4. Te ndryshme**

Pas transferimit të pjesëve të kapitalit tek Blerësi, behet pronar i ligjshëm i 67 aksioneve që përbejnë 67% të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë dhe ushtron të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë që ligji i njej zotëruarit të aksioneve të përcaktuara në objektin e kësaj kontrate si nga pikëpamja e ushtrimit të së drejtës së votës dhe të pjesëmarrjes në shpërndarjen e fitimeve.

Shitësi humbet të gjithë të drejtat dhe përgjegjësitë që buronin nga aksionet e shitura dhe deklaron se nuk ka pretendime të asnjë lloji ndaj shoqërisë dhe/ose aksionareve të saj.

**5. Baza Ligjore**

Kjo kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore të cilës i behet referim në këtë kontratë.

Kjo kontratë pasi u lexua prej meje Noterit, u gjet në përputhje me vullnetin e lire e të plote të palëve dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre në praninë time në katër kopje origjinale dhe unë Noteri e vërtetoj këtë sipas ligjit.

**SHITESI**

Andi Kume



**BLERESI**

Xhezmi Kadi

